

PALA SHITese me nenshkrimin e kesaj kontrate i njeh pales blerese te drejten e zoterimit ne 1/22 pjese, ose 4.6 % te kuotave ne kapitalin themeltar ne shoqerine « BIRRA KORCA » sh.p.k.

PALA BLERese njeh detyrimin te shlyeje perfundimisht vleften totale brenda afatit te percaktuar me lart. Ne rast te kundert, pala shitese rifiton te drejten e zoterimit ne kuotat (pjeset) prej 1/22 ose 4.6% ne kapitalin themeltar te blera prej pales blerese ne kete kontrate, si dhe te drejten e mbajtjes se pageses se kryer si kest i pare prej 10.000 (dhjete mije) EURO.

PALA SHITese njeh detyrimin te respektoje kushtet e kesaj kontrate ne lidhje me vleren, diference te papaguar sipas marreveshjes ne kete kontrate. Pas nenshkrimit te saj, nga pala shitese per asnje shkak nuk do te diskutohet vlefta totale e shitjes se pjeseve prej 1/22, ose 4.6 % te kuotave

PALA SHITese z. Mihallaq Qeleshi, humbet cilesine e Ortakut ne shoqerine « BIRRA KORCA » duke u larguar prej kesaj shoqerie.

PALA BLERese, fiton cilesine e Ortakut ne kete shoqeri.

Sa me siper kontrata e shitblerjes u redaktua ne baze te nenit 45 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", nenit 39 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine". Kontrata iu lexohet paleve me ze te larte.

Palet kontraktuese deklarojne se e kuptojne permbajtjen e saj dhe nenshkruajne ne fund pa asnje verejtje. Bashkengjitur prokura e posacme e pales shitese ne emer te perf. Dashamir Topciu.



Ky akt hartohet ne tre faqe te lidhura, ne kater ekzemplare me fuqi ligjore te barabarte. Njeri prej tyre depozitohet ne kete zyre noterie, tre te tjerat u dorezohen perkatesisht njeri pales shitese, dy te tjerat pales blerese per kryerjen e veprimeve prane Regjistrat Tregetar.

Une noteri qe redaktova kontraten e shitblerjes ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe pasi e gjej aktin ne pajtim me ligjin, nenshkruaj dhe vertetoj rregullisht.

PALET

SHITESI



Mihallaq Qeleshi
perfaqesuar me prokure
Dashamir Topciu
emri, mbiemri, firma

BLERESI

Shoqeria "EGNATIAGROUP"
perf. Besnik Duka
emri, mbiemri, firma

NOTER



**KONTRATE E SHITBLERIES
(KUOTAT E KAPITALIT THEMELTAR)**

Në Korçë, sot më datën 1.10. 2004, para meje notere Flora Biba, u paraqitën personalisht, palët kontraktuese me cilësinë e mëposhtme:


SHITESI: Z. Mihallaq Qeleshi, ibiri i Thanasit, dl ___ lindur në Korçë aktualisht banues në Worcester, MA SHBA, me cilësinë e Ortakut përfaqësuar me prokurë të posaçme, datë 13.07.2004 (noteri publik A.Afezolli), nga zoti Dashamir Topçiu, i biri i Kapos ky i fundit me nr. pasaportës 1034815.

BLERËSI: Shoqëria "EGNATIA GRUP" sh.a. person juridik me vendim nr.28285 datë 23.09.2002, me cilësinë e Ortakut përfaqësuar nga Drejtori i saj Zoti Besnik Duka, i biri i Mit'hatit dl.10.11.1955, banues në Tiranë dokumenti nr. Z0598794.

Të dy me zotësi të plotë juridike për të vepruar që me vullnetin e tyre të lirë kërkuan redaktimin e aktit noterial të shitjes së kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë tregëtare "**BIRRA KORÇA**" sh.p.k..

Me vendim gjyqësor nr.1571 datë 11.02.1994 në Regjistrin Tregëtar pranë gjykatës së shkallës së parë, Tiranë, është regjistruar si person juridik shoqëria "**BIRRA KORÇA**" sh.p.k.. Objekti i veprimtarisë, kohëzgjatja, kapitali themeltar ortakët, (gjithësej 11) dhe pjesët takuese të tyre në kapitalin themeltar, përkatësisht 1/11 pjesë, përcaktohen shprehimisht në statutin dhe akt-themelimin e saj.

Me vendimin gjyqësor nr. 157/4 datë 30.06.2004, të gjykatës së Shkallës së parë Tiranë, z.Mihallaq Qeleshi, si njëri prej trashëgimtarëve të ish Ortakut Thanas Qeleshi, (cilësi e fituar me dëshminë e trashëgimisë vendim nr.1118 dt. 05.05.1995 të gjykatës së shkallës së parë Korçë, ka fituar pronësinë mbi 1/22 pjesë, ose 4.6% të kutave të kapitalit themeltar të shoqërisë "**BIRRA KORÇA**" sh.p.k. E drejta e tij është fituar sipas



Statutit të Shoqërisë dhe Ligjit 7638 datë 19.11.1992 «Per shoqërite Tregëtare»

Me vendim nr. 11 datë 17.06.2004, Asambleja e Ortakëve në përputhje me kompetencat sipas ligjit 7638 datë 19.11.1992 ka vendosur: **Miratimin e transferimit** nëpërmjet shitjes së pjesëve të kapitalit themeltar sipas kuotave zotëruese të Ortakëve tek "EGNATIA GROUP" sh.a. Në bazë të nenit 45 të Ligjit 7638 datë 19.11.1992 "Per Shoqërite Tregëtare", hartohet kontrata noteriale e shitjes.

PERMBAJTJA E KONTRATËS:

SHITESI:

Ortaku Mihallaq Qelesi është zotërues në 1/22 pjesë, ose 4.6 % pjesë të kuotave të kapitalit themeltar.

Ai ia shet ato tërësisht **BLERËSIT** "EGNATIA GROUP" sh.a. me vlerë totale të shitjes 150.000 (njëqinde e pesëdhjetë mijë) EURO.

BLERËSI:

"EGNATIA GROUP" sh.a. pranon blerjen e kuotave (pjesë) takuese prej 1/22 pjesë ose 4.6% në kapitalin themeltar të shitur nga z. Mihallaq Qelesi me vlerë totale të shitjes 150.000 (njëqinde e pesëdhjetë mijë) EURO.

Shlyerja e vlefes së kuotave (pjesëve) të shitura bëhet si vijon:

Kesti i parë prej 10.000 (dhjetë mijë) EURO, shlyhet në dorë nga blerësi tek shitesi sot në ditën e nënshkrimit dhe vertetimit të kësaj kontrate para meje noterit.

Kesti i dytë dhe perfundimtar, (diference e mbetur), në shumën prej 140.000 (njëqinde e dyzetë mijë) EURO, do të shlyhet në dorë nga blerësi tek shitesi me këtë afat: deri në 1 janar 2005

Per shlyerjen e vlefes, diference e mbetur sipas paragrafit të mesiperm, blerësi do të nënshkruajë deklaratë para noterit duke garantuar blerësin se ka marrë shumën e mesipërme prej tij.

Palet kontraktuese deklarojnë se janë dakort me mënyrën e likuidimit të vlerës së shitjes parashikuar si më lart.